



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 500, Datë 07.03.2018**

**“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimeve publike për ndërmarrjet “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07.03.2018, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi kërkesë/ankesën e Agjencisë së Prokurimit Publik.

**Baza Ligjore:** Neni 4 dhe 42 (1) i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).  
Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

**Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:**

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

**VËREN SE :**

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, Agjencia e Prokurimit Publik (APP), ka depozituar shkresën me Nr. 533, datë 26.12.2017, lidhur me shqyrtimin e “marrëveshjes në oferta” në prokurimin publik elektronik me objekt “Riparime të zyrave të objektit Njësia Administrative Lukovë”, Bashkia Himarë, bazuar në raportin e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) për këtë prokurim, pasi mendohet se mund të ketë shkelje të nenit 4 (marrëveshja në oferta) të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.20103 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”.
2. Autoriteti i Konkurrencës, në vijim të procedurave ka kërkuar informacion nga KLSH dhe Bashkia Himarë për vënie në dispozicion të dokumentacionit përkatës që lidhen me procedurën e prokurimit dhe nga vlerësimi i dokumentacionit të depozituar në rrugë elektronike në sistemin e prokurimit të APP nga ndërmarrjet pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit, rezulton se:
  - Në procedurën e prokurimit, ofertues fitues është shpallur operatori ekonomik

“A.E.K & Co” SHPK me vlerën 2,232,864 lekë e cila është afër fondit limit me 99.79% të tij;

- Dy operatorë ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, ndërmarrja “Tea-D” SHPK dhe ndërmarrja “A.E.K & CO” SHPK, kanë ngarkuar të njëjtin dokument në sistemin elektronik të prokurimit dhe pikërisht “Vërtetim Debie – për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike”, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Gjirokastrë e OSHEE, për ndërmarrjen “Tea-D” SHPK me Nr. 135 Prot., datë 06.08.2015.
  - Referuar Preventivave të depozituar nga të dy operatorët ekonomik, ndërmarrja “Tea-D” SHPK dhe ndërmarrja “A.E.K & CO” SHPK, rezulton se janë pothuajse identike dhe kanë ndryshime të disa zërave me një shtesë uniforme 10 lekë tek disa zëra punimesh.
3. Nga vlerësimi i kërkesës së APP, materialit të KLSH-së dhe dokumenteve të depozituara nga ndërmarrjet “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK, në procedurën e prokurimit publik me objekt “Riparime të zyrave të objektit Njësia Administrative Lukovë”, vlerësojmë se mund të jemi përpara një marrëveshje të ndaluar në oferta midis këtyre 2 (dy) ndërmarrjeve, në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma (a) të Ligjit Nr. 9121/2003.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 42 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

#### **VENDOSI:**

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik për ndërmarrjet “Tea-D” SHPK dhe “A.E.K & CO” SHPK;
2. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**